

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenet 109 të Ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092

Një ankesë kundër: **INSTITUTI I MJEKSISË PUNËS KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 72701-20-3652-1-2-1

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Paisje mjekesore (AUTO REFRACTOMETER)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Almakos Group sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ilaz Kodra Nr. 5

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

044 715 689

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Petrit Doli


(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

almakosgroup@gmail.com

(Adresa elektronike)

14.10.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftim për Kontrate - Data e publikuar: 15.07.2020
Njoftimi mbi Vendimin e AK –së – Data e publikuar: 01.10.2020
Vendim i Kërkesës për Rishqyrtim - Data e publikuar: 07.10.2020
Afati i fundit për dorëzim të tenderit: 04.08.2020 ora: 12:00
Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Me date **05.10.2020** kemi bere kërkesë për rishqyrtim pranë **AK INSTITUTI I MJEKSISË PUNËS KOSOVËS**.

Te bashkangjitur mund te gjeni “**Kërkesën për Rishqyrtim**” si dhe “**Vendimin ndaj Kërkesës për Rishqyrtim**” nga **AK INSTITUTI I MJEKSISË PUNËS KOSOVËS**.
te datës **07.10.2020**

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Është shkelur;

Neni 1 – Qëllimi,

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve

Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Bazuar në “Njoftimin mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues” te datës: **01.10.2020**, dhe “Vendimin e Kërkesës për Rishqyrtim” të datës **07.10.2020** vendimi i marrë nga Komisioni Vlerësues është i pa bazuar;

Ne “Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar” të publikuar me datë: **01.10.2020**, tenderi ynë është refuzuar me arsyetimin se:

- Katalogu është prezantuar, por nuk është prezantuar i nënvizuar siç është kërkuar në njoftim për kontratë si dhe dosje të tenderit.”

Së pari, në “Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar” paraprake të datës **13.08.2020** tenderi ynë është refuzuar vetëm për arsye të pretendimit nga ana e AK-së për çmim jo-normalisht të ulët, gjë që bazuar në vendimin e OSHP-së me numër **590-593-**

602/20 të datës: 25.09.2020 ky pretendim i AK-së është hedhur poshtë si i pa bazuar, ku i bie se tenderi ynë ka qenë teknikisht i përgjegjshëm atëkohë dhe tani në “**Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar**” të publikuar me datë 01.10.2020 refuzohet tenderi ynë me arsyetimin se katalogu nuk është nënvizuar.

Në “**Vendimin e Kërkesës për Rishqyrtim**” të datës: 07.10.2020, tenderi ynë është refuzuar me arsyetimet se;

Arsyetimi i AK-së pika 1.):

1. *OE nuk i kane plotësuar kërkesat minimale të dosjes së tenderit dhe Njoftimet për kontratë pasi që nuk e ka plotësuar tabelën me të dhënat e specifikimeve teknike të evidentuara për secilin artikull me të cilin oferton, pra komisioni vlerësues nuk ka pasur asnjë mundësi të vlerësoj ofertën pasi që ka qenë e pa mundur të vlerësohet sepse mungon deklarata për specifika teknike si dhe mungon tabela me të dhënat e specifikave të kërkuara.*

Asnjë prej pretendimeve nga ana e AK-se për piken 1). nuk qëndrojnë;

Në dosje të tenderit ne e kemi ofruar tabelën e plotësuar në të cilën tabelë kemi bërë krahasimin e specifikacionit teknik të ofruar nga ana jonë me atë të kërkuar në dosje të tenderit.

Si dëshmi në dokumentin “**1. DOSJA 006**” (e cila është pjesë e tenderit) në faqen **Nr. 4** dhe **Nr. 5** gjendet tabela e plotësuar e krahasimit të specifikacionit teknik të ofruar nga ana jonë me atë të kërkuar në dosje të tenderit.

Po ashtu kemi ofruar edhe Deklaratën e Përputhshmërisë siç është kërkuar në **Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FTD) - Neni 3.1, pika a)**

a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Arsyetimi i AK-së pika 2.):

2. *OE nuk i kane plotësuar kërkesat minimale të dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë as për katalogun e nënvizuar me specifika teknik pasi që ka ofruar një Katalog të përgjithshëm dhe të pa nënvizuara pozicionet që ka ofruar, komisioni vlerësues e ka të pamundur të vlerësoj një katalog që nuk është i nënvizuar ajo që është ofruar siç e ka kërkuar dosja e tenderit dhe njoftimi për kontratë.*

Pretendimet e AK-se për piken 2). nuk qëndrojnë:

Në dosje të tenderit ne kemi prezantuar katalogun e pajisjes të ofruar ku dhe kemi nënvizuar me ngjyrë të verdhë modelin e ofruar “**Huvitz Auto Ref/Keratometer HRK-9000A**”.

Tenderi ka të bëjë me një pajisje si tërësi dhe një model ku specifikat teknik për pajisjen e ofruar janë të prezantuara në katalogun në formatin PDF - “**8. HRK-9000A-eng.pdf**”

Specifikat e ofruara në katalog janë të saktësuara për modelin e ofruar dhe janë të dedikuara vetëm për modelin **HRK-9000A** që do të thotë se nuk është ofruar katalog i përgjithshëm siç pretendohet nga ana e AK-së por është ofruar katalog specifik me të dhëna të detajuara për modelin e ofruar dhe nuk mund të ketë asnjë arsyetim për komisionin vlerësues të AK-se që ta ketë të pamundur të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e specifikacionit teknik të ofruar nga ana jonë.

Arsyetimi i AK-së pika 3.):

3. *AK nuk ka mundur te kërkoj informata shtese ne mungese te katalogëve te përshtatshme apo specifikave. AK duhet te refuzoj pa asnjë lajmërim, ne te kundërtën AK nëse do kërkonte informata shtese për specifikat teknike do bënte shkelje pasi qe procesi i hapjes ka ndodhur dhe çdo ndryshim ne specifika teknike apo kataloge nuk është e lejuar sepse OE do i ishte dhënë mundësia te ndryshoj/përshtat specifikat dhe te markoj sipas dëshirës pas procesit te hapjes se ofertave.*

AK ka vepruar drejt ne vendimin e vetë sipas nenit 28 dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim te vendimit.

Po ashtu edhe Pretendimi nga ana e AK-se për piken 3.) nuk qëndron;

Sipas RrUOPP, neni 39. Sqarimi i Tenderëve, pika 39.8, Neni i LPP-se 28;

Problemi: Ne rast se Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu.

Si te veprohet: Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm.

Në rastin tonë nuk mungon as Specifikacioni teknik dhe as Katalogu për mallin e ofruar.

Në këtë pikë AK nuk e ka respektuar **Nenin 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe RrUOPP Neni 39** duke mos kërkuar asnjë informatë sqaruese.

Vlen të ceket që edhe pas vendimit të OSHP-së Nr. **590-593-602/20** për te njëjtën lëndë duke pasur parasysh pretendimin tonë që ka të bëjë me çmimin, ku eksperti shqyrtues konsideron se AK nuk ka pasur parasysh neni 1 te LPP-se pasi qe do duhej qe te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike; tentohet që të shpërblehet me kontratë po i njëjti Operatori Ekonomik **“Arben S. Ismajli B.I. (KO-MED)”** me çmim prej **19,250.00 Euro**, çmim i cili është më shumë se dyfishi i çmimit te ofruara nga ana jone i cili është me vlerë prej **9,200.00 Euro** ku kemi ofruar me një pajisje e cila i plotëson te gjitha kushtet e parapara në kërkesë.

Çmimi i ofruar nga ana jonë është çmim real dhe i arsyeshëm për një pajisje te tillë te kërkuar nga ana e Autoritetit kontraktues ku ne si **“Almakos Group sh.p.k.”** ka **10 (dhjetë)** vite qe jemi përfaqësues te autorizuar te Prodhuesit **“Huvitz Co.Ltd”** për Kosovë dhe ne territorin e Kosovës kemi distribuuar rreth 70% te aparaturave te ndryshme Oftalmologjike te Prodhimit **“Huvitz”** kryesisht **“Auto Refraktometra”**

Po ashtu vlen te ceket se kemi serviser te trajnuar ne Korenë e Jugut për servisim dhe mirëmbajtje te pajisjeve Oftalmologjike.

Kërkojmë nga ana juaj që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar dhe lënda te kthehet në rivlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkakttojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

--

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*